

PROCESVERBAL V/2024

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 5 (pestë) për vitin 2024 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi:	Suharekë
Zyra:	Salla e Kuvendit të Komunës
Data:	30.05.2024
Ora:	10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci

Z.Selman Kolgeci

Z. Flamur Bytyqi

Z. Urim Suka

Z. Kushtrim Kuçi

Znj. Elmaze Bytyqi

Znj. Bulëza Kuçi

Znj.Doruntina Zenelaj

Z.Alban Berisha

Z. Bexhet Kuçi

Z. Reshat Selimaj

Z. Lirim Qatani

Z. Aziz Bytyqi

Znj.Sanie Kuçi-

Rexhepaj

Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina

Z. Vullnet Luzhnica

Z. Xhevxhet Gashi

Z.Edon Sadikaj

Znj.Saranda

Bajraktari

Znj.Mimoza Bajraktari

Znj.Festë Kabashi

Z.Dardan Berisha

Z.Bajram Basha

Znj.Mevlude Kabashi

Znj.Sheqerije Zyrapi

Znj.Laureta Tafaj

Z.Liridon Fandaj

Z.Qëndrim Elshani

Z.Herolind Limaj

Znj. Jehona Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

**Kryetari Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI**

**Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zonën Qendër” në Suharekë;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm të “Hisarit” në Suharekë;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për këmbimin e pronës komunale në pronën private;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunes;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit;**
- 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e Artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjen “13 Qershori” ;**
- 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2023 të komisionit komunal të aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A. ;**
- 9. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës 01-Nr-553-15422;**
- 10. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - para se ta hedh në votim rendin e ditës do të tërhiqen nga rendi i ditës pika 2 dhe pika 3 e rendit të ditës.Kryesuesi jep sqarime sa i përket tërheqjes së dy pikave të rendit të ditës dhe e hedh në votim rendin e ditës pa pikën 2 dhe pa pikën 3 të rendit të ditës.

Unanimisht Miratohet

Xhevxhet Gashi - përshëndes të pranishmit.Dua të ju njoftoj se nga sot do t’i bashkangjitem LDK-së .I falemnderoj asambleistët e AAK-së për bashkëpunimin dhe prapë do të punojmë sëbashku për të mirën e qytetrëve.

Kryesuesi - në emër të grupit të falemnderoj për kontributin e dhënë gjatë gjithë kësaj periudhe dhe të urojmë suksese në subjektin e ri politik.

Urim Suka - në emër të grupit të LDK-së i urojmë mirëseardhje Xhevxhet Gashit në grupin tone.E dime që për secilin asambleist është në vullnetin e tij me vendos për rrugëtimin e ri politik që do ta bëjë.

Dardan Berisha - kur ka dal Festa prej Listës Guxo në AAK,më kujtohet kur Urimi patë thënë që ka dal me presion politik.Nuk e di çfarë presioni ka pas Xhevxheti por si do çoftë i urojmë kolegut suksese.

Qëndrim Elshani - i uroj suksese Xhevxhetit në subjektin e ri politik,i uroj mirëseardhje në opozitë dhe shpresoj të vijë shumë prej juve kah ne në opozitë.

Urim Suka - unë e kam uru Festën atëherë dhe nuk kam pas ndonjë qëllim të caktuar mirëpo një asambleist kur del nga opozita te pushteti mund të paragjykohet ideja që mund të ketë presion dhe qëllime të caktuara ndërsa kur nga pushteti vjen te opozita,ai nuk vjen për interesa të veta por vjen për me mbrojtë një kauz më të përgjithshme.

Dardan Berisha - për kundër shefit të grupit të LDK-së unë nuk flas me paragjykime,unë flas me gjëra konkrete.

Aziz Bytyqi - e përshëndes kontributin e Xhevxhet Gashit në subjektin tonë.Mendoj që vlera e demokracisë nuk qëndron te lëvizjet prej një këndi në këndin tjetër por qëndron te pluralizmi politik.I urojmë shëndet e suksese.

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për këmbimin e pronës komunale në pronën private;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Shefket Kolgeci - drejtori nuk qenka por unë kërkoj të di qëllimin e këmbimit në pika të shkurta dhe më të qarta se prej ku po zgjerohet rruga.

Kryesuesi - drejtori është në udhëtim zyrtar dhe në material janë pak a shumë sqarimet.

Shefket Kolgeci - ndoshta më konkret do ta kishte sqaru drejtori i urbanizmit edhe pse jemi pro dhe kemi qenë pro por një sqarim për asambleistët do të ishte më mirë.

Liridon Fandaj - edhe në KPF e kam ngrit si shqetësim.Kur ka ardhë si propozim,drejtori i urbanizmit ka thënë që ne përfitojmë nga kjo pjesë e këmbimit.Realisht në bazë të vlerësimit nuk përfitojmë asgjë por edhe e paguajmë një pjesë në vlerë prej 4200€.Kryesues,ti ke thënë që pala ka hek dorë nga kompenzimi.A ka diçka të shkruar sepse nëse nuk ka një dokument të shkruar,ai mund të thotë që po heq dorë por dhe nesër prap e kërkon kompenzimin.

Armend Krasniqi - faktikisht komuna nuk ka humb asgjë mirëpo komuna në favor të 144 m që e ka marrë, e paguan afësisht 4000€ që e ka vlerësu Ministria e Financave.120 m² i ka dhënë,144 m² i ka marrë mirëpo në kuadër të kësaj parashtresë i kërkesës në bisedën që e kemi pas,ka thënë që nuk është i interesuar me marrë kompenzimin e asaj vlere dhe tash mbetet nga parashtresë i kërkesës se si merr vendim mirëpo komuna detyrohet që ta bëj kompenzimin.

Laureta Tafaj - pa e dhënë zotëriu në fjalë një vet deklaratë që po e fal atë pjesë atëherë ti nuk guxon as me marrë andaj dua një sqarim nga zyrtari ligjor.

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor jep sqarime dhe thotë që në momentin që ky vendim e merr miratimin në kuvend dhe konfirmimin nga MAPL-ja, Kryetari i komunës është i obliguar sipas këtij vendimin të nënshkruaj kontratë mes komunës dhe palëve të cilët kanë hy në proces të këmbimit dhe ti përcaktojnë kushtet dhe mënyrën e bartjes së pronës dhe këmbimin e pronës. Sa i përket çështjes së kompenzimit palët merren vesh se a do ta falin këtë kompenzim apo komuna e merr obligim që ta kompenzoj.

Laureta Tafaj - pra kjo nuk qenka e definune dhe paska edhe hapa tjerë për me ndodh ajo?

Avni Bytyqi - e thashë që me kontratë kanë me u specifiku kushtet dhe kriterët se si bartet prona dhe normal pasi të kryhet ky proces sepse nuk kemi desht që të hyjmë në proces të deklaratave, me u tërhek nga kompenzimi pa e marrë konfirmimin e ligjshmërtisë,pa u bërë i ekzekutueshëm dhe pa prodhu efekt juridik ne me hy në procedura të panevojshme.

Liridon Fandaj - kërkesa a ka qenë e atyre personave apo ka qenë e Komunës?

Armend Krasniqi - interesat më të mëdhaja janë të komunës se sa të pronarit mirëpo për shkak të interesave të dy palëve është kërkesë e përbashkët mirëpo sa e di ka lind prej Drejtorisë së Urbanizmit.

Selman Kolgeci - e kam analizu skicën dhe nuk kam vërejtje dhe në parim jemi për me kalu këtë vendim.Më intereson të dijë,pala a është pajtu me raportin e vlerësimit dhe me nivelin e largësisë së vlerësimit të metrës katror për atë zonë?

Avni Bytyqi - edhe prona private edhe prona publike është vlerësu e barabartë dhe deshën apo nuk deshën palët ne duhet me u pajtu sepse vlerësimin final e jep ministria. E kanë të drejtën e ankesës por e kanë vetëm në gjykatë. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Selman Kolgeci - e kam të qartë por a keni bisedu me palët dhe me i thënë që ky është vlerësimi dhe a e pranoni këtë vlerësim sepse nëse e kanë pranë këtë vlerësim unë e di që ata nuk kanë të drejtë më me bë ankesë.

Kryesuesi - pasi e kemi sjell këtu besoj që janë pajtu.E hedh në votim pikën 2.

28 për, 3 apstenime,Miratohet Pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - e kuptojmë drejtorin për punën dhe angazhimin që e ka bë mirëpo nuk e mirëkuptojmë për faktin që për neve po na duket që janë duke u marrë disa vendime selektive ku për dikënd komuna vepron dhe për dikënd nuk vepron dhe në rastin konkret komuna ka vepru për këto prona që janë banesa ku njerëzit kanë jetu aty dhe nuk kanë kriju të hyra për vete ndërsa ka plotë prona tjera të cilat janë të dhëna në shfrytëzim dhe nuk kryhen procedurat ligjore sipas kontratës dhe komuna nuk vepron.Unë nuk kam dëshirë që komuna me vepru në mënyrë selektive por me vepru mbi bazën e një të drejte ku barabarësisht me u trajtu secili pronar që e ka marrë një parcelë të komunës.Ky vendim do ta ketë përkrahjen tonë.

Armend Krasniqi - punën intensive që po e bën drejtorja e pronës është për me u përshëndet. Në këtë rast kemi marrë një vendim adekuatë ,kemi marrë edhe shumë vendime adekuate për të cilat jemi duke punuar intezivisht.Besoj që sa është punuar 2 muajt e fundit në Drejtorinë e Katastrës,nuk është punuar 25 vitet e kaluara dhe kjo punë duhet të duartrokitet sepse nuk është veprim selektiv mirëpo është veprim i mirëmenduar,mirëorganizuar dhe i mirërealizuar.Nëse ke diçka konkrete se ku nuk po veprojmë,thuj.

Shefket Kolgeci - kam një propozim që këto banesa mos të jepen në ankand për qeramarrje ku ka edhe konkurrencë.Ne e dime që është një regjistër i familjeve të dëshmorëve që disa familje të dëshmorëve kanë marrë banesa por ka ende shumë që nuk kanë marrë.Ndoshta është dasht të ndiqet forma ligjore por unë kisha propozu që të formohet komisioni i caktuar,le të shpallet konkursi për ata dëshmor.Unë jam që këto banesa t'i jepen familjeve të dëshmorëve.

Kryetari - falemderoj të gjithë për prezencën gjithëashtu dua ta falemderoj ish asambleistin e AAK-së dhe tash i LDK-së Xhevxhet Gashin për punën dhe angazhimin dhe i uroj suksese. Sa i përket kësaj pike është një procedurë që s'mund ta kaloj as unë dhe as ju.Janë disa rregulla që janë vendos më herët,formohet komisioni.Kush e ka fat le ti merr sepse ne po mundohemi më shumë të bëjmë.

Alban Berisha - Armend të përgëzoj për punën edhe pse jam opozitë sepse shoh shumë gjëra pozitive që bëhen prej Drejtorisë së Pronës ku na vin shumë vendime prej Drejtorisë së Pronës që unë i vlerësoj shumë pozitive dhe ato që i kemi vlerësu pavarësisht debateve ne i kemi votu por nuk më pëlqen që po thua qe 25 vjet.A e ke edhe 4 vjeqarin e kaluar?Je duke bë punë por asnjëherë s'po të dëgjoj duke e përmend që kem pak motivacion edhe prej Kryetarit.A keni koordinim apo jeni duke punu veq e veq?

Armend Krasniqi - me sinjeritetin më të madh të them,secilin komision që kam qenë unë,as një pronë,asnjë lokal,asnjë banesë nuk e ka nda as Kryetari,as drejtori dhe as anëtarët e komisionit por e ka nda ligji.

Alban Berisha - as Kryetari e askush por pronat ose banesat i ndan Asambleja.Nuk është që nuk është punu qe 25 vite dhe të lus ta heqësh nga fjalori sepse ka pas drejtori,ka pas njerjz që kanë punu,dikush më pak e dikush më shumë.

Armend Krasniqi - në pronë dhe katastroë është punu por është punu më shumë keq se sa mirë mirëpo analizat që janë bë nga Drejtorja e Pronës në vitet e fundit janë analiza të cilat janë përshëndet jo vetëm nga ti mirëpo edhe nga organizata të huaja të cilat veprojnë në Kosovë.

Liridon Fandaj - te projekt-vendimi desha një sqarim prej zyrtarit ligjor sepse Kryetari e tha që është pa pagesë dhe besoj që në konkurim të hapur duhet me qenë një vlerë. A ka me pas një vlerë apo veq ka me u dhënë në shfrytëzim pa pagesë.

Avni Bytyqi - kjo çështje u ngrit edhe në KPF dhe aty kam thënë që nuk mund të paragjykojmë dhe nuk guxojmë me paragjyku që ka me marrë ky ose ai. Ne kemi me shku sipas procedurave që e parasheh ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme si dhe rregullorja që i përcakton procedurat dhe kriterët për dhënie në shfrytëzim të pronës publike.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3 për 99 vite.

Liridon Fandaj - nëse dikush e merr për 99 vite dhe nuk e marrin familjet e dëshmorëve, unë nuk mendoj që duhet me qenë 99 vite.

Kryesuesi - ne po i ndjekim procedurat.

Alban Berisha - a ekziston mundësia që ne si organ me nxjerr një rregullore për ndarjen e pronave ? p.sh. familjet e dëshmorëve me i pas me një akt të veçantë. E kemi gadishmërinë të gjithë.

Avni Bytyqi - ne e kemi pas dhe e kemi rregulloren deri në vitin 2010 që ka qenë në fuqi. Në vitin 2010 ka hy në fuqi ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronave të paluajtshme si dhe akte tjera nënligjore dhe rregullorja e kuvendit komunal ka ra, është shfuqizuar dhe ne jemi të obliguar që ti përmbahemi këtij ligji dhe kësaj rregullore dhe akteve nënligjore që miratohen nga qeveria dhe nuk ka mundësi sepse bie në kundërshtim me ligjin dhe rregulloren.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3 për 99 vite.

27 për, 3 apstenime, Miratohet Pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Dardan Berisha - në legjislaturën e kaluar 2017-2021 e kemi propozuar këtë vendim, tash na ka ardhë një vendim tjetër për me rrit plus 50€. Unë në KPF kam kërku që kësaj shume ti shtohet edhe 50€ nëse ka buxhet për ata njerëz të cilët ndërrojnë jetë në spitalet e Prizrenit ose në Prishtinë sepse transporti parashihet vetëm në qytetin e Suharekës. Kjo kërkesë është e grupit të PDK-së.

Urim Suka - ne në KPF jemi pajtu me propozimin e Dardanit që nëse është mundësia ligjore për këto raste, të ketë një buxhet plus 50€. Pra 250€ për të gjitha rastet tjera dhe 300 me qenë për rastet që vdesin në spitale për shkak të transportit. Mirëpo gjatë diskutimit është thënë që teknikisht a ka mundësi bashkësia islame këtë çështje me bë dhe keni marrë obligim me diskutu me bashkësinë islame. A e keni diskutu këtë çështje me bashkësinë islame dhe nëse ne e marrim këtë vendim a mundet me ndodhë? Nëse e keni diskutu dhe ata e kanë pranuar, ne pa diskutim që do ta mbështesim.

Kryetari - ne nuk mund ta çekim vetëm Prizrenin dhe Prishtinën sepse kemi pas raste edhe në Tiranë dhe në Shkup. Sa e di, me kapacitetin që e kanë ata është pak e problem me mbulu edhe këtë pjesë dhe në fund ata duhet me arsyetu te ne. Ne barazohemi në fund me çertifikata të vdekjes sa i sjellin por është edhe një problem që paguhen me subvencione dhe nuk paguhen me mallra dhe shërbime. Kryetari tutje jep sqarime dhe thotë që me një pikë shtesë është mirë me aprovu sot por dhe me fut në rregullore që në qoftëse nuk i kryejnë obligimet ata nuk paguhen. Ju si të doni vendosni.

Mimoza Bajraktari - a ka mundësi të ndahet një buxhet dhe të blehet një automjet për bashkësinë islame të cilët mund ti bartin vet pavarësisht se ku ndodhë që mos të jetë problem dokumentacioni.

Kryetari - dy vetura ia kemi dhënë bashkësisë islame por e kanë problem te fuqia punëtore. Unë kisha thënë që të shkoni me 250 € njëherë dhe nëse e shohim të arsyeshme, ne mund të marrim vendim tjetër në Asamble.

Dardan Berisha - para takimit të KPF-së unë e kam vizitu bashkësinë islame dhe e kemi diskutu këtë çështje dhe ata janë dakordu që vetëm 50 me i lëshu sepse në bazë të buxhetit komunal që mos me ngarku shumë, unë kam kërku në KPF edhe më shumë, pra me fut edhe arkivolin. Ata transportin e kanë dhe thanë që është mirë me shtu edhe 50€.

Kryesuesi - sa i përket transportit ne e dimë që i kanë.

Liridon Fandaj - unë e mbështes propozimin e Dardanit por ne po ia japim një të drejtë vetëm bashkësisë islame. Ne e kemi edhe komunitetin katolik. Do të ishte mirë secili familjar me shku me një kërkesë sepse ata ndoshta nuk dojnë me shku në bashkësinë islame. Edhe Urimi e ka propozu në KPF që familjarëve me ia dërgu paratë dhe jo me cek vetëm bashkësinë islame që i kryen këto rite.

Kryetari - ne i kemi marrëveshjet me tri palët dhe i kryejmë të gjitha.

Dardan Berisha - nëse ngarkohet buxheti e lëmë me 250 por realisht shumica e qytetarëve nuk i dinë këto procedura dhe ka shumë prej tyre që i kryejnë vet.

Agim Bylykbashi - ju e dini që subvencionet i përcakton Ministria e Financave dhe ne si Komunë mund të bëjmë kërkesë me u rrit tavani i subvencioneve por është problem sepse duhet me pas arsyeshmëri të mirë. Është mirë siq tha Kryetari 250 dhe në qoftëse Ministria e Financave në qarkoren e dytë na pranon rritjen e tavanit të subvencione atëherë ne vendosim si Kuvend me një vendim shtesë edhe për 50€.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4 me vlerën 250€.

25 për, 4 apstenime, Miratohet Pika 4

Pika 5. Shyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e Artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjen “13 Qershori” ;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Elmaze Bytyqi - kur jemi te ky vendim, ne si LDK i japim mbështetje punës së komisionit në fjalë dhe i miratojmë këto propozime. Lidhur me këtë temë dua që në emër të kuvendarëve të LDK-së të propozojë që në të ardhmen duke u mbështetur në normativat, propozimet me theks të veçantë kur janë post mortum e sidomos ato të të njejtës kauzë p.sh martirët e luftës kur kanë një status si kolektiv të një institucioni apo diçka të ngjashme, të ndahen çmime jo vetëm për individët por për të gjithë personat e të njejtit status. Ky qëndrim mbështetet me arsyetimin se në rastet e caktuara një individ i ndahet çmimi dhe familjarët e personit tjetër ndjehen të anashkaluar edhe pse ideja është që çdo vit të ndahen çmime dhe planifikohet që të gjithë të marrin këto çmime dhe për disa që nuk kanë propozues mundet që këto çmime të mos i marrin asnjëherë.

Kryesuesi - çmimi “Emblema e Artë” jepet vetëm një dhe mirënjohja “13 Qershori” është e paraparë vetëm pesë.

Elmaze Bytyqi - a mundemi si pako me i përfshi të gjithë viktimat?

Kryesuesi - po në të ardhmen po.

Urim Suka - qëllimi është që familjet e martirëve në rastin kur martirët kanë rënë në luftën e fundit, dikujt me një lagje po i bje në mend me propozu dhe dy shtëpi më andej është një familje e njejtë dhe kjo po merr dhe ajo s’po merr për rastin e njejtë. Qëllimi është si komunë mos me lënë në nivelin e propozimit kur dikush e bën por me i trajtu këto familjet si të barabarta. Sa i përket numrit, ushtarët që kanë marrë në koshare të gjithë, a janë vetëm 5 apo janë më shumë sepse po thoni vetëm 5.

Kryesuesi - janë më shumë dhe janë si pako. Le të vjen propozimi në të ardhmen si pako.

Dardan Berisha - këta e marrim vetëm si brigadë 138 Agim Ramadani, komplet brigada dhe në këtë rast mundemi me shtu një pikë në rregullore që me ju dhënë viktimave të luftës ose shoqatës së viktimave të luftës.

Kryesuesi - vitin e ardhshëm do ta kemi parasysh dhe besoj që do të kryhet. E hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet Pika 5

Pika 6. Shyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2023 të komisionit komunal të aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A. ;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - raportin e kemi diskutu dhe në KPF por nuk kam mundur të marr sqarime. Është një pikë ku thotë që komisioni komunal i aksionarëve ka vendos që në bazë të performancës së mirë që

anëtarja e bordit të drejtorëve ka,ti vazhdohet mandati tre vjeçar si anëtare e bordit në bazë të performances.Në cilin ligj ose rregullore janë bazu që një anëtar i të bordit iu ka vazhdu mandati? Te rritja e të hyrave është për me u lavdu sepse në krahasim me vitin e kaluar,6000€ janë rrit të hyrat por nuk po mund të kuptoj si ka mundësi që kapitali në pasqyra financiare është 2.243.692,55 ndërsa në ARBK kapitali i kësaj ndërmarrje është 10.000€.Çfarë vlerësimi të kapitalit kanë bë ?Nëse dikush hyn dhe e sheh në ARBK se çfarë kapitali ka kjo ndërmarrje,del që i ka veq 10.000€ ndërsa në pasqyra financiare nuk ka asnjë shpalosje të këtij kapitali ose një listë të kapitalit të kësaj ndërmarrje.

Reshat Selimaj - ligji 06/L-016 për shoqëritë tregtare,drejtorit mund ti vazhdohet mandati për një afat të pacaktuar dhe mund ti merret në bazë të performacës.Sa i përket 10.000€,kjo është që kur mbledhen dy shifrat e dy viteve është fitim dhe ne jemi të obliguar me raportu dhe sa i përket ARBK-së ,ne kemi apliku shumë herë por e kemi problem kuotën gjinore që po e kërkojnë me çdo kusht me respektu por gjinia femërore nuk vijnë dhe ky është problem i cili do të përsëritet prap deri sa nuk e plotësojmë kuotën gjinore.

Liridon Fandaj - unë thashë te pjesa kapitalit.Çdo ndryshim i kapitalit çdo vit që bëhet ose vlerësim,je i obliguar me ndryshu edhe në ARBK.Vlera 2 milion duhet me pas një list kapitale.A e keni bë një regjistrim të lokaleve që ka sepse nuk ka asnjë të dhënë për ato?

Reshat Selimaj - duhet ta falemderoj z.Armend Krasniqi që e ka zgjidh një problem që është me vite.Ne do të aplikojmë për licencim,kemi edhe pak procedura të vendimit të pronës dhe takimin e radhës do ti sjell të gjitha ty.

Kryesuesi - besoj që për deri sa nuk ka qenë prona e zgjidhur,nuk ka mund ta bëj edhe regjistrimin e asateve dhe e falemderoj Drejtorin e Pronës që ka arrit me zgjidh një problem të vjetër.

Armend Krasniqi - për deri sa nuk e ka pas çështjen e pronësisë të rregulluar,ky stacion ka punuar pa licencë.Drejtoria e pronës e ka shqyrtu dokumentacionin dhe e ka finalizu në fund duke e rregullu çështjen e pronësisë dhe duke e realizu atë që nuk e kanë realizu të tjerët më parë.Me marrjen e licencës nuk rrezikohet më vendi i 40 punëtorëve të cilët punojnë aty.Sa i përket lokaleve shumë shpejt drejtoria e pronës do të regjistroj çdo detaj aty.

Alban Berisha - shumë mirë që u zgjidh ky problem dhe presim që mbas zgjidhjes së problemit të dokumentacionit plotësues për ta marrë statusin e ndërmarrjes.Presim që do të investohet në stacion dhe të ndërrohet pamja e stacionit.Jam i shqetësuar që u desh kaq vite me u zgjidh ky problem pronësor.Pa desh me dhënë detaje,a ke informacion se a ka qenë neglizhencë prej organeve komunale që nuk e kanë pas vullnetin me zgjidh apo ka pas interesa të caktuara që kjo nuk është zgjidh për shkak se dikujt i ka konvenu mos me u zgjidh?

Armend Krasniqi - unë mendoj që tri çështje kanë ndiku në moszgjidhjen e kësaj problematike.Ka mungu profesionalizmi,guximi dhe neglizhenca.

Alban Berisha - guxim ndaj çkafit?

Armend Krasniqi - nëse nuk ke profesionalizëm,nuk ke guxim.Drejtori tutje jep sqarime.

Alban Berisha - fjala guxim më shqetëson si asambleist.E pranoj që edhe unë me qenë drejtor i pronës duhet me qenë i guximshëm sepse disa vendime nganjëherë janë të ndieshme dhe nganjëherë duhet me qenë e guximshme dhe normal ndjeshmëria është kur ka të bëj me një familjet që e ka gjendjen sociale-ekonomike shumë të keqe dhe ti duhesh me marrë një vendim me liru një pronë.E guximshme është kur preket një interes i një personi të forte.A ka ende probleme të këtij lloji të pazgjidhura?

Armend Krasniqi - për çështjen e pronës duhet me mbajtë seanca të shumta për me i diskutu problematikat që ekzistojnë.Sa i përket problemeve specifike,ka qindra probleme,çoftë në familje,çoftë në pasuri shoqërore mirëpo ku po insiston te guximshmëria,guximshmëri do të thotë me u ballafaqu me secilin dokument sepse gjithmonë jemi frigu mos po gabojmë diçka në aspektin profesional.Duke analizu të gjitha detajet e kemi konstatu që gjithëçka është në rregull dhe kemi vendos me ekzekutu një çështje e cila ka qenë çështje jo e mirë për Suharekën.

Reshat Selimaj - ndoshta edhe me të drejtë drejtori tha guxim duke marrë parasysh që unë jam që 12 vite dhe 12 vite jam ballafaqu me këto kërkesa dhe kur është marrë nuk është refuzu që kjo është me ligj brenda 14 dite punë ose një muaj punë dhe këta me u përgjigj që për këtë arsye nuk zgjidhet ky problem.Unë të falemderoj tej mase që je ballafaqu me këto dhe ju ke tregu të gjithë atyre që nuk ka pas

problem.U desh me pas vullnet dhe guxim me u ballafaqu me dokumenta që ne ti kemi arsyetu si komision.

Alban Berisha - është hera e pestë që kërkoj dhe është shumë shqetësuese pse po ndodh dhe si po ndodhë etinoari i autobusave prej stacionit qëndror deri te stacioni i dytë që është te ballkani.Jo që rrezikohet komunikacioni,rrezikohet siguria publike,rrezikohet jeta e njeriut se si shkon autobusi prej stacionit deri posht 5 në orë,7 në orë në mëngjes.Kjo gjithmonë ka ndodhë dhe është duke ndodhë.A është kompetencë e policisë a e kujt nuk e di.Ne gjithmonë duhet të marrim masa dhe të ndalet kjo para se të ndodh e keqja.

Kryesuesi - edhe unë jam i shqetësuar me këtë fenomen dhe ajo është pengesë në komunikacion por kjo është kompetencë e policisë kurse inspektori e ka për detyrë me shiku a pe zbaton internorarin.Është shqetësim që është duke u bartë mirëpo vetëm gjrobat munden me përmirësu.

Reshat Selimaj - edhe unë jam i të njëjtit mendim por po e gjejnë një arsyetim në këto 2-3 vitet e fundit që po punohet në shesh por përveq pengesave që i bëjnë ne planifikojmë planin buxhetor për një vit nga këto kompani dhe ne na rrezikojnë në plan duke ik anasjelltas.Kam pas disa takime me drejtoreshën dhe kur e kanë dhënë maksimumin inspektorët,është vërejt atë ditë por është problem me i menaxhu.E kemi pas konsideratë gjendjen financiare të kompanive por detyrimisht do të na qojnë me i inkasu blanko për një vit.

Alban Berisha - propozoj që nëse është mundësia,çoftë ju si ekzekutiv,çoftë komisioni ose edhe ne si asamble bashkë me u taku me shoqatën e tyre dhe me bisedu me ta që të mos na rrezikojnë.

Kryesuesi - jan taku,kanë bisedu por nuk ju ka zgjat shumë.E hedh në votim pikën 6.

27 për,3 apstenime,Miratohet pika 6

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës 01-Nr-553-15422;

Kryesuesi - e elaboron pikën 7 dhe hap debatin.

Aziz Bytyqi - mirë që po ndimohet kjo familje e cila ka pësuar fatkeqësisht por kemi edhe një rast tjetër që ka ndodh në fshatin Nishor ditën e diel,ku familjes së dëshmorit Ymer Bytyqi pas goditjes nga rrufeja iu ka djeg i gjithë kulmi dhe duhet me pa mundësinë me i ndihmu edhe kësaj familje sepse rasti është i njëjtë dhe qytetarët me të drejtë mund të ndjehen të pabarabartë në trajtim.Kryetari më ka thirr ditën e njëjtë dhe është i informuar se çka ka ndodh dhe po ashtu më ka thirr edhe shefi i gupit të LVV-së që e falemderoj dhe po ashtu e ka shpreh vullnetin edhe privatisht me i ndihmu por qytetari që është dëmtu ka kërku ti ndihmohet vetëm institucionalisht nëse ekziston mundësia sepse nuk do ta ngushtoj askënd.Është një dëm e cila e kalon shumë 10.000€.

Kryetari - ne më herët e kemi pas një fond emergjent për vërshime,shtëpitë që janë kall dhe për rrufe mirëpo tash nuk e kemi atë kod.Ne tash kem shku me kategorinë e subvencioneve sepse nuk kemi mujt me gjet metodë tjetër.Është mirë ta bëjmë një rregullore të veçantë dhe me iu ndihmu të gjithëve ose të bëhet kërkesë seancën e radhës dhe si ka ardhë kjo procedure, të shkojmë edhe me këtë procedurë.

Laureta Tafaj - e përgëzoj vendimin për zotëriun në fjalë.Raste të tilla ndoshta ka me pas çdo muaj.Shpresojmë që jo por nëse jo për një shtëpi ka me qenë për një sëmundje.Jo të ulemi të mendojmë siq tha Kryetari por a e vendosim sot me bë një zgjidhje për një fond emergjent?

Kryetari - edhe unë jam me ty.Po e fusim në buxhet por të garantoj që kur e kemi fut në buxhet para tre viteve,na kanë hek fondin emergjent dhe ne e fusim prap në buxhet por nuk kanë me pranë.Për rasatin që tha Azizi mundemi me mbyll sot këtë rast dhe i fusim të dyja por po thonë duhet të bëhet një kërkesë andaj ta presim kërkesën dhe e vendosim.

Jehona Rrafshi - ndiej keqardhje për rastin që ka ndodh në Nishor.Unë mendoj që sot me shku vetëm me kërkesën e qytetarit të fshatit Bllacë për shkak që kemi prit tre muaj për këtë procedurë dhe jam që kërkesa e banorit të fshatit Nishor të vje në një seancë tjetër.

Urim Suka - shprehim keqardhje për rastin e ndodhur dhe i japim mbështetje për mundësinë që ka Komuna për mi dalë ndihmë edhe kësaj familje.Si LDK i japim mbështetje propozimit për të cilin po flasim dhe lusim që kjo të implementohet sa më shpejtë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 7.

Pika 8. Pyetje dhe përgjigje;

Selman Kolgeci - para dy seancave është miratu plani i mobilitetit të qëndrueshëm urban, a ka fillu të zbatohet ai plan, rekomandimet e të cilit jemi pajtu të gjithë, të cilat kanë për qëllim rritjen e sigurisë në komunikacion, rritjen e sigurisë së këmbësorëve, ofrimin e lehtësirave tjera në komunikacion, ofrimin e jetës më cilësore, stimulimin e përdorimit të transportit publik e ofrimin e infrastrukturës për përdorimin e mjeteve e bicikletave. A kanë fillu të zbatohen rekomandimet që kanë dal nga ai plan apo edhe ky dokument i rëndësishëm e ka fatin e shumë dokumenteve tjera? Pyetje për Kryetarin dhe për të gjithë drejtorët të cilët kanë kontrata aktive në teren. Jemi dëshmitar që shumë projekte që po fillojnë në komunën tonë kudo, projektet po zvarriten, po tejkalohet çdo plan dinamik e çdo afat i paraparë për përfundimin e tyre e përpos tyre realizimi i tyre po bëhet me cilësi skajshmërisht të dobët. Z. Muharremaj dhe drejtorë komunal, a jeni në dijeni që jeni përgjegjës edhe ju edhe operatorët ekonomik për këto vonesa? A keni kërkuar nga ta që të jenë më të përgjegjshëm lidhur me realizimin e kontratave e mos të shkaktojnë vonesa në realizimin e kontratave? Z. Muharremaj, zyra e prokurimit në Suharekë me dijeninë dhe me aprovimin tënd ka nis shumë procedura të prokurimit me kriter të dhënies tenderi ekonomikisht më i favorshëm si dhe me këtë kriter ka nënshkruar disa kontrata dhe ajo që më shqetëson është fakti që me këtë metodë ju po i thoni kompanive të afërta me juve që: ejani konkroni, ne ju paguajmë më shtrenjtë se sa çmimi i tregut për disa pozicione shumfish më shtrenjtë se sa çmimi i tregut vetëm se në këmbim të një zotimi që ato punë të kryhen për një afat më të shkurtër. Përpos që nuk po kryhen në afat më të shkurtër, ato po zgjaten më shumë se sa afati i zakonshëm. Z. Muharremaj nuk po e kuptoj pse po e përdorni këtë formë. Për rastet specifike kur jemi në prag të mbylljes së vitit mund të ketë ndonjë rast ku kërkohet plani dinamik me u kry shpejt dhe mos me shku mjetet suficit e kuptoj por problemi është se pse në janar, shkurt e mars. Tek stacionet e autobusave jemi dëshmitar që led ekranet janë shëndrru në funksion të promovimit tuaj personal dhe jo në shërbim të qytetarëve për çka edhe janë ndërtu. Përpos kësaj ka edhe disa kompani që i kam pa dhe dua të di që në çfarë forme kanë bërë marrëveshje kompanitë për me u reklamuar aty? Apsolutisht s'ka asgjë të keqe kur përfundon faza e informimit të publikut me orarin e autobusave, mund të përdoret zbrazëtira me biznese por nuk po e kuptoj pse promovimin personal dhe nuk po e kuptoj formën se si është arrit ajo marrëveshje dhe ku po shkojnë ato mjete, kush i inkason ato mjete dhe çka po ndodh me ato mjete? Drejtor Bylykbashi, jemi në sezonin e pranverës dhe e dime që shumica e rrugëve kanë nevojë për intervenim, dua të di a ka naj plan konkret në sanimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale? Po ashtu edhe te ndriçimet ka shumë vendbanime në të cilat ndriçimet nuk janë funksionale. Tek ulëset në shtegun e ecjes në Vraniq, shumë ulëse si pasojë e mos fiksimit në mënyrë adekuate kanë fillu me lëviz dhe nëse nuk intervenohet me kohë unë mendoj që shumë shpejt ato kanë me qenë të papërdorshme dhe kërkoj nga drejtori me intervenu atje. Tek Drejtoria e Bujqësisë e kemi diskutu para disa seancave një shqetësim lidhur me tjetërsimin e mekanizmave bujqësor në disa raste të caktuara. A keni kontroll mbi to? Kryetar, kërkoj që të përgjigjesh në emër të zotit Kuçi. Kemi kërku edhe unë dhe disa asambleist të tjerë raport për HZK-në por nuk po vje ai raport. Në Hartë Zonale në pjesën tekstuale ju keni thënë që kaq million euro kanë me ardhë investime në Suharekë duke u mbështet në këtë dokument. Tregona sot ku je me Hartë Zonale? Tek kanalizimi në Vraniq, e kam diskutu unë, e ka diskutu edhe doktor Shefketi në seancën e kaluar dhe ju e keni pranuar një dështim të tillë por më intereson të di tash kur keni me fillu me sanu në Vraniq?

Kryetari - Plan i mobilitetit ka fillu të zbatohet në komunën e Suharekës. Sa i përket sigurisë në komunikacion është e vërtetë që vërejtjet janë dhënë prej seancës së radhës kompanive që janë duke punu në rrugën "Skënderbeu" dhe në shesh, dhe besoj që në shesh maksimumi në fillim të javës lëshohet rruga. Te plani dinamik, para një jave i kemi thirr operatorët, menaxherët dhe e kemi procesverbalin ku e kam dhënë vërejtjen e fundit, që ata që nuk e zbatojnë planin dinamik do t'i ndërpriten kontratat. Sa i përket shetitores në fshatin Vraniq, e ka një garancion. Agim është mirë me iu drejtu kompanisë që i ka kry punimet me një vërejtje dhe me dal me pa. Te kanalizimi në Vraniq kemi pas probleme shumë të mëdha ku asnjë pale nuk na ka lënë me punu as në anën e majtë dhe në të djathtë me rregullu kanalizimin. Paret

janë nda në Asamble komunale nëse nuk gabo 150.000€ dhe ka hy operatori ekonomikë me 80.000 € ose 90.000€.E di që tri vikende kam shku vet në Vraniq dhe e kam thirr edhe asambleistin edhe të gjitha partitë politike por asnjëherë nuk kanë qenë të interesuar me dalë dhe me pa.Deri sa nuk na mundësojnë qytetarët,në atë vend është e pamundëshme me rregullu kanalizimin si duhet për shkak se disa kaskada ka në shtratin e lumit.Për punët që po vonohen pajtohem me ju por besoni që ka problem me kompani dhe fuqi punëtore.

Selman Kolgeci - plani i mobilitetit mirë që ka fillu por ku saktësisht ka fillu?

Kryetari - ka fillu te rruga “Skënderbeu”,ka fillu në shesh dhe ka fillu në shumë vende tjera por prit të përfundojnë punimet dhe kur të përfundojnë punimet ke të drejtë me dhënë kritika.

Selman Kolgeci - në dy projektet që përmende ti nuk mund të fillojë zbatimi i planit të mobilitetit sepse janë duke u kry punimet me kontrata tjera.Ke plot vende tjera ku mund të fillosh me implementu këtë plan të mobilitetit.

Kryetari - bëje një kërkesë me shkrim dhe drejtori përgjigjet në seancën tjetër.

Ardian Kotorri - e mora një pyetje dhe shqetësim të asambleistit Kolgeci.Mund të ketë dukuri të tilla por realisht ne si drejtori e Bujqësisë vazhdimisht jemi në teren edhe për subvencionet që i shpërndajmë dhe mjetet që i ndajmë por megjithëatë ne nuk mund të kemi kontroll 100 % për gjithë shpërndarjet tona por nëse vërejmë dukuri të tilla,natyrish do të marrim masa të cilat janë të parapara me ligj.Ne punojmë sipas rregullave dhe kemi pas auditime për këto punë dhe nuk kemi pas problem në këtë drejtim.

Selman Kolgeci - nuk pata vërejtje tek pjesa se si i keni shpërnda por pata vërejtje për formën se si po shiten mekanizmat bujqësor prej atyre që ne po i konsiderojmë bujk.

Ardian Kotorri - është mirë me emra sepse na jep një informacion neve si drejtori.

Selman Kolgeci - bëja një kontrollë listës që iu ke shërnda dhe mos i shtin bujqit që vërtetë punojnë me i ble paisjet me gjys çmimi prej atij që ti ia ke dhënë.

Ardian Kotorri - unë ju garantoj që bashkë me stafin e drejtorisë vazhdimisht jemi në teren,vazhdimisht i vizitojmë edhe ata që i kemi furnizu me sera,i kemi furnizu me mekanizëm bujqësor.Unë nuk guxoj me mohu për shkak se mbi 500 mekanizma shpërndahen dhe ndoshta mund të ketë ndonjë rast devijant të tillë por të garantoj me dijen tonë nuk ka diçka në këtë drejtim.

Dardan Berisha - një shkresë që ka ardhë prej klubit “ KF Suhareka” është diskutu edhe në KPF dhe e kemi lënë me dalë në teren dhe me gjet një zgjidhje për klubin.Ti na ke premtu Kryesues që do të na ftosh të gjithë shefat e grupeve parlamentare dhe do të dalim në teren që ta gjejmë një zgjidhje për ta.Shqetësimi i tyre është që nuk po iu lejohen stërvitjet sepse ata me ligj e kanë me shfrytëzu fushën në terenin sportive por ata detyrohen me shku nëpër terene tjera.Ku ka shku ky proces?

Kryesuesi - si shkresë mua nuk më ka ardhë por është e vërtetë që e kemi diskutu në KPF dhe shumë shpejt do të takohemi dhe duhet t’ia bëjmë një zgjidhje edhe atyre.

Laureta Tafaj - është e shtata herë që e bëj një kërkesë dhe është e shtata herë që e kam marrë një premtim prej ish Drejtorit të Shërbimeve Publike dhe Kryetarit për një rrugë në Greikoc për sanimin e saj.Shtatë herë me më thënë po publikisht dhe asnjëherë mos me mujt me sanu një rrugë,është e pa drejtë.Kam kërkesë prej qytetarëve të asaj pjese për rrugën “28 Nëntori” që të bëhet sanimi i saj.

Agim Bylykbashi - është e vërtetë që kemi probleme shumë me sanime të rrugëve,me puseta dhe kërkesa të ndryshme të qytetarëve.Para një jave e kemi inicu procedurën për sanime dhe besoj që kemi me i kry të gjitha punët ku ka nevojë.

Urim Suka - pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike: 1. Në Bllacë për gjatë rrugës kryesore është ndërtu një pjesë e trotuarit por ky trotuar nuk është përfundu në tërësi pasi një segment në dalje të Bllacës për gjatë rrugës “Ymer Krasniqi” ende nuk ka përfundu dhe nxënësit,qytetarët që frekuentojnë në këtë pjesë detyrohen të ecin në rrugë duke qenë të rrezikuar nga makinat.Cili është plani juaj për vitin 2024,a do të përfundoj edhe kjo pjesë e trotuarit gjatë këtij viti apo jo?

2.Ditë më parë jam kontaktuar nga një qytetar që jeton në rrugën “Shaban Polluzha” në Suharekë dhe sipas informatave që mora nga qytetari dhe sipas asaj që hulumtova kuptova që ju si pushtet keni planifikuar ndërtimin e kësaj rruge në vitin 2021 madje për këtë ju keni lidh edhe një kontratë mirëpo rruga nuk ishte shtruar fare as në vitin 2021 dhe as tani.A mund të më tregoni për arsyet e dështimit të ndërtimit të kësaj rruge dhe cili është plani juaj në të ardhmen për këtë rrugë. 3. Dy ditë më parë kur ishin

reshjet e fundit kam pranuar nga një qytetar disa video që dëshmonin problemet me kanalizim në lagjen “Rrafshi” në Duhël. Sipa tij ka katër vite që kanalizimi në këtë pjesë është blloku dhe përkundër kërkesave dhe njoftimeve që ai ka bërë, nuk ka marrë kujdesin e duhur nga ju. A jeni në dijeni me këtë problem dhe a keni planifikuar që t’u dilni në ndihmë këtyre familjeve për zgjidhjen e problemeve të kanalizimit?

Agim Bylykbashi - meqenëse unë nuk jam në ngjarje për të gjitha projektet që kanë ndodhë, rruga “Shaban Polluzha” që e përmende, është e vërtetë dhe personi në fjalë që ke kontakti ka qenë në zyrën time. Ajo rrugë ka qenë e shtruar por është dëmtu dhe ka nevojë me u rregullu dhe do të shohim në buxhetin e viti të ardhshëm. Sa i përket trotuarit unë nuk kam informata se kur është bërë ky trotuar sepse nuk ka në buxhet trotuar këtë vit për Bllacë. Në kanalizimin në lagjen “Rrafshi” unë e kam pa atë video. Personit në fjalë duhet me i thënë që ne si komunë e kemi obligim me bo kanalizimin edhe pse komuna nuk e ka obligim me bo kanalizim nëpër shtëpi private ose lagje por komuna e ka obligim me bo kanalizimin e përbashkët të fshatit e sa i përket që ky kanalizim është zënë atëherë le ti drejtohet hidroregjionit.

Urim Suka - për pjesën e rrugës “Shaban Polluzha” unë e kam vizitu dhe e pash që ish e shtrune rruga por ankesat ishin që edhe kur është shtru është shtru keq dhe ju e konstatuat edhe vet. Ajo që ngrita unë është përkundër që kjo rrugë ka qenë e shtrune ju keni lidh një kontratë dhe pyetja ishte që ju për deri sa keni lidhë një kontratë, cila ka qenë arsyeja pse nuk është shtru rruga?

Agim Bylykbashi - thashë që nuk jam në ngjarje se çka ka ndodh në vitin 2021 mirëpo e di që ajo rrugë ka qenë e shtruar dhe në raportin e menaxheri të kontratës me siguri shkruan për arsyet se pse nuk është shtru kjo rrugë. Drejtori tutje jep sqarime.

Liridon Fandaj - Pyetje për Drejtorin e Arsimit: e kam një shqetësim nga një punëtor i arsimit që para disa kohe ka dalë e ka shpërfaq një dukuri brenda shkollës dhe ai sot është në masë disiplinore. A do të thotë kjo që dikush që e ngrit zërin brenda arsimit dhe e shpërfaq një dukuri negative, me këto komisione disiplinore tentohet t’mbillet goja? Tjetër është një kallzim penal të cilin e kemi pa në bazë të mediave për një konkurs në fshatin Samadraxhë. A mund të na jepni sqarim, a është punësu aty dikush pa konkurs apo është vetëm një lajm në media dhe s’ka të bëjë asgjë me këtë? Pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike: Te projektet kapitale, pse deri tash nuk kanë dalë në tenderim në bazë të planit të prokurimit të gjitha projektet që janë në bazë të planit dhe në bazë të kohës dhe afateve që janë të përcaktuara në prokurim. Pyetje për Drejtorin e Bujqësisë: Cila është analiza që ju e keni bërë për thirrjen publike për subvencionimin e arrave dhe lajthive dhe a nuk do të ishte mirë që të bëhet një analizë dhe të shihet cilët janë sektorët apo veprimtaritë bujqësore që ministria nuk i subvencionon dhe mi përkrahë ato? Pyetje për Drejtorin e Inspeksionit: para disa dite në rrugën “Skënderbeu” është rrënu një shtëpi dhe Kryetari e ka bërë një postim dhe besoj që ajo makineri është e urdhnune nga komuna. A ka pas uzurpim të pronës publike aty apo është dasht me ia kry një shërbim dikuj dhe fondin e Drejtorisë së Inspeksionit me shpenzu për rrënim?

Remzi Bajselmani - sa i përket rastit në gjimnaz janë marrë organet e hetuesisë, e kanë trajtu rastin dhe është dalë që prononcimet e mësimdhënësit kanë dalë të rrejshme dhe në fund shkolla ka kërku që për shkak të prishjes së imazhit të shkollës dhe shqetësimit e gjithë qytetarëve të Suharekës, të trajtohet si rast. Është formu komisioni atëherë që e trajton rastin dhe presim rezultatet e komisionit. Sa i përket mediave që shkruajnë portalet për kallëzime sigurisht e dini edhe ju që kallëzimet mund ti bëjë gjithëkush por i shqyrtojnë organet e drejtësisë dhe në fund del rezultati.

Agim Bylykbashi - është e vërtetë që në bazë të planit të prokurimit ne kemi ngec pak me procedura mirëpo këtë vit kemi vendos që asnjë projekt kapital nuk do të shkojë në procedura për inicim të projektit pa u kry projekt. Pra, jemi duke i prit kompaninë me i bërë të gjitha projektet për të gjitha projektet kapitale dhe me vazhdu me inicimin.

Liridon Fandaj - a do të thotë kjo që nëse nuk ka një projekt dhe nëse ne e kemi votu atëherë u dasht me pas një projekt që ne e kemi votu dhe sot me vazhdu por nëse deri në fund të viti ne e kemi votu dhe nuk ka projekt prej kompanisë projektuese atëherë këto projekte nuk do të rizotohen.

Agim Bylykbashi - projektet gjithmonë janë votu në asamble por projektet bëhen më vonë. Drejtori tutje jep sqarime.

Ardian Kotorri - prej viti 2022 ne si komunë e bëjmë subvencionimin për liter të qumështit poashtu e kemi vlerësuar si drejtori që ta mbështesim edhe këtë kulturë të arrës dhe lajthisë. E kemi pas si iniciativë për këtë vit me vazhdu me kulturën e arrës dhe lajthisë mirëpo nuk do të thotë që nuk do të bëjmë subvencionime edhe për kultura tjera. Jemi në fazën e analizës. Drejtori tutje jep sqarime sa i përket subvencionimeve.

Aziz Bytyqi - me që u përmend rruga “Shaban Polluzha”, në atë rrugë jetoj unë. Shqetësimi i qytetarit të asaj lagje është i drejtë. Unë jam marrë me ato shqetësime, kam bisedu me ish drejtorin e shërbimeve publike me dhjetra herë, kam bisedu edhe me kryetarin dhe drejtorin aktual. Është fakt që ajo rrugë është planifiku të shtrohet në 2021-tën, nuk ka pas kontratë por vetëm ka qenë në investime kapitale me sa kam informacion, nëse nuk gabo. Kur ka ardhë punëkryesi e ka pa atë rrugë që ka qenë e shtruar dhe atëherë ka ekzistuar në buxhet e të tjera dhe kanë shkuar në shtrua disa rrugë që nuk kanë qenë të shtruara asnjëherë. Ajo rrugë vërtetë është e dëmtuar dhe besoj që drejtori duhet me dal me vizitu atë rrugë dhe ajo rrugë ose duhet me hy me sime sivjet ose të paktën me parapa në buxhet për vitin e ardhshëm.

Urim Suka - arsyeja pse po ndërhy është se Azizi më njeh dhe e din që unë kur të them ka kontratë, e kam pa atë kontratë dhe Azizi e mohoi të qenurit e kontratës. Unë për korrektësinë tuaj ja ku e kam kontratën ku shkruan rruga “Shaban Polluzha” me emër konkret. Kur e kam pa kontratën unë e mora obligim me ngrit shqetësimin e qytetarit dhe në këtë kontratë është edhe rruga “Bubulina” e cila tash është shtrua. Nuk flas pa qenë i sigurt.

Aziz Bytyqi - unë e thashë: me sa e di unë dhe nëse nuk gabo. Unë e kam një përgjigje të ish drejtorit që ajo është në investime kapitale për vitin 2021. Aziz Bytyqi tutje jep sqarime.

Kryesuesi - rruga “Shaban Polluzha” është e dëmtuar prej kompanisë së Hidro Regjionit kur i kanë vendos pusetat e ujit kurse rruga “Bubulina” nuk është shtruar dhe unë jam dëshmitar që disa banorë të lagjes më kanë thirr dhe kanë kërku që rruga mos me u shtrua pa u rregullu kanalizimi. Tash u vendos kanalizimi dhe u shtrua rruga “Bubulina”.

Albulena Kokollari - është e vërtetë që Drejtoria e inspeksionit ka bërë disa rrënime në rrugën “Skënderbeu” për shkak se komuna e Suharekës është duke e bërë realizimin e projektit kapital “Ndërtimi dhe rregullimi i kolektorit në rrugën “Skënderbeu”. Drejtoria e Urbanizmit i ka njoftu më herët të gjithë banorët e asaj rruge për lirim e hapsirave publike dhe ne si drejtori kemi fillu dhe i kemi njoftu prap për të disatën herë dhe gjithëashtu komuna e Suharekës ka pas interes për largimin e këtyre hapësirave publike për shkak se këto ndërtime kanë qenë në hapësira publike dhe ne i kemi ndjek të gjitha procedurat administrative të inspeksionit dhe e kemi bërë rrënimin e këtyre objekteve.

Liridon Fandaj - nëse ti i ke ndjek të gjitha procedurat është në rregull por nëse është për zgjerim të rrugës atëherë një kontratë është për atë rrugë aty dhe nuk është obligim i drejtorisë së Inspeksionit por vetëm nëse ka peng.

Kryetari - ose kemi me shku te krejt njëjtë ose s’kemi me shku. I kemi tri raste te rruga “Skënderbeu”. Është Shaljani i parë dhe është e vërtetë që dytë kanë pas leje por kur i kanë marrë lejet nuk janë largu së paku 10-12 metra por kanë shku edhe në pronë komunale. Njërit iu ka heq vetëm aneksi e tash është në megj dhe ai nesër me dal nuk mundet për shkak që ka me dalë n’pronë publike. Rasti i dytë ku thua ti Liridon, është procesi, janë matjet gjeodezike dhe mund ti kërkon letrat.

Liridon Fandaj - a i është bërë proces atij? sepse nuk mundemi ne me qu parandë publike për një rrënim kur ai e ka zaptu dhe ai duhet me pagu për atë pjesë.

Kryetari - në muajin nëntor është marrë vendim me u liru të gjithë pronat publike.

Qëndrim Elshani - pak më herët u laku emri i rrugës “Bubulina”, rrugë e cila e kam ngrit shqetësimin seancën e kalaur që kanalizimi nuk është duke u shtrua si duhet dhe më duket që këto llafe kanë shku në vesh të shurdhër dhe ka vazhdu puna me u bë njëjtë, gjithmonë po flas sipas banorëve të lagjes. Shqetësim tjetër i tyre është që nëse ndërtohen dy-tre shtëpi më tepër, ai kanalizim duhet të ndërrohet sepse diametri i gypit është dy herë më i vogël se sa duhet me qenë. Kompania punëkryese ka bërë disa dëme në disa shtëpi në atë lagje. Kur do të del inspeksioni me i verifiku ato dëme dhe ti kompenzoj familjet të cilat janë dëmtu? A ka ndonjë datë se kur do të rregullohet shtëpia e kulturës sepse shumë shpesh po e dëgjojmë thënien: e nisi Salihu, e betisi Baliu. Por unë mendoj që duhet me qenë: e nisi Salihu e betisi ministria.

Kryetari - me rëndësi është me u kry shtëpia e kultures dhe as nuk është me rëndësi kush e nisi as kush e betisi.Seancën e kaluar ke reaguar për kanalizimin te rruga Bubulina dhe menjëherë e kam verifiku që ai është gyp FI 200 me standarte dhe ke të drejtë me kërku llogari.Në fshatin Duhël,deri sa i lidhim krejt kanalizimet dhe ujrat atmosferik me një vend çdo herë kemi me pas probleme.

Urim Suka - sapo hyra te miratimi I buxhetit që e kemi bë në tetor dhe e pash që rruga “Bubulina” nuk është në planifikim fare për vitin 2024 ndërsa ajo po shtrihet.Mbi çfarë kontrate po shtrihet ajo rrugë për deri sa nuk është e planifikuar?

Kryetari - rrugët në Suharekë janë të paraparë me kontratë dy vjeqare dhe në çoftëse ka qenë një herë në buxhet,ne rrugët i shpallim me meter katror.Në shumë raste kemi pas problem me konteste.Kryetari tutje jep sqarime.

Urim Suka - Krejt planifikimin e buxhetit sa jam unë në asamble kemi planifiku dhe miratu buxhetin me rrugë dhe emra konkret,jo me metra katror.Metrat katror bëhen në ato projektet dhe paramasat.

Kryetari - ne jemi në obligim të qytetarëve 24 orë dhe në moment që kryhen ato punë dhe teprojnë pare,shkojmë me një vendim të Kryetarit dhe i shtojmë ato rrugë që kanë qenë në buxhet dhe çdo herë me kërkesë të menaxherit dhe aprovim të Kryetarit.

Albulena Kokollari - Drejtorja e Inspeksionit ka marrë disa ankesa prej qytetarëve që ka dal në teren mirëpo Drejtorja e Inspeksionit nuk bën vlerësime të dëmeve.

Qëndrim Elshani - kush e bën vlerësimin e dëmeve?

Ardian Kotorri - unë jam menaxher prej komunës por ne e kemi pas një kompani të jashtme mbikqyrëse dhe ajo e ka bë vlerësimin e punëve dhe kualitetin e punimeve dhe përgaditjen e raporteve të situacioneve për pranimin e punëve.Realisht nuk kemi pas një problem të tillë por e di që ka pas një problem ku banorët janë anku për diametrin e gypit dhe e kemi zgjidh ku realisht ka qenë 200-ndësh gypi.Për probleme tjera nuk kam informacion në këtë drejtim por nëse ka unë do të interesohem që sot mbasdite.

Lorika Gashi - Kryetari ta dha përgjigjen dhe gjithësesi besoj që duhet me qenë krenar të gjithë dhe uroj që në përrurim të asaj shtëpie kemi me qenë të gjithë bashkë.Punëkryesi,menaxherët dhe mbikqyrësit e kanë bë një punë të shkëlqyeshme deri në këtë moment.Janë disa detaje të vogla dhe besoj që në shtator kemi me festu dhe uru atë shtëpi të kultures.

Shefket Kolgeci - nuk e di a do ti thirrni asambleistat në atë përrurim kur do të bëhet.E keni shpall sportistin e viti më herët s’e keni ftu asnjë asambleist,të paktën mua dhe grupin tim jo.

Ballkani u bë kampion,nuk na keni ftu asnjë.

Lorika Gashi - aktivitetet e drejtorisë së kultures janë të shpallura në shumicën e rasteve ose në faqen e drejtorisë ose të komunës,kështu që është ftesë publike për të gjithë.Për shtëpi të kultures po të thërras publikisht.

Takimi përfundoi: 12:22

Procesmbajtësja:

Dafina Haziraj